VENDIM
Nr. 191, datë 15.3.2017

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI *FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT* TË GODINAVEDHE TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8210, ME NUMËR PASURIE 3/74,ME SIPËRFAQE 5 044.85 m², DHE ME NUMËR PASURIE 3/183, ME SIPËRFAQE 1 580.89 m² *DHE ME NUMËR PASURIE 3/389, ME SIPËRFAQE 56 M²*

(Ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 29.4.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi *Fondit Shqiptar të Zhvillimit* të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5 044.85 (pesë mijë e dyzet e katër pikë tetëdhjetë e pesë) m² dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1 580.89 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë pikë tetëdhjetë e nëntë) m², sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1/2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të ndërtesës me sipërfaqe të përgjithshme 498.6 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtë) m², e cila pozicionohet në pasurinë nr. 3/74, me sipërfaqe 363.1 (treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë një) m², në pasurinë 3/183, me sipërfaqe 79.5 (shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) m², dhe në pasurinë nr. 3/389, me sipërfaqe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) m², ndodhur në zonën kadastrale 8210, Tiranë, sipas planrilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

1/3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ta tjetërsojë pronën ose ta japë në përdorim te të tretët që nuk janë struktura apo subjekte në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, *Fondi Shqiptar i Zhvillimit* dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
EdiRama


3/98
3/179
3/96
3/185
3/203
3/185
3/178
3/56
3/209
3/66
3/208
3/210
3/207
3/122
3/93
3/119
3/70
3/91
3/144
3/81
3/180
3/88
3/89
3/153
3/90
Sip m2 =1580.89
3/183
6/63
6/62
3/68
3/86
6/69
8210
3/72
3/154
3/73
3/184
3/85
6/388
3/74
6/73
3/131
6/440
3/81
3/71
6/441
6/50
3/82
3/84
6/288
6/1
3/132
6/136
6/442
Sip m2 = 5044.85
3/65
6/140
6/443
3/133
6/138
6/141
6/12
3/76
6/145
3/182
3/80
3/189
6/156
3/78
6/144
6/142
3/200
6/143
6/50
3/87
6/160
8220
6/159
6/164
1:1,000
6/434
6/161